



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 132/ 2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Ferizaj, paraqitur kundër, për shkak të paraqitjes në TV Tema të Kryeministrat për përkrahjen e kandidatit për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**REFUZOHEȚ** si e pabazuar ankesa, e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Ferizaj.

### **Arsyetim**

PZAP, më datë 02.05.2010, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se gjatë bisedës përfshirë zgjedhor në emisionin TV Tema Kryeministri Hashim Thaqi ka përmendur dhe përkrahur kandidatit për kryetar të komunës nga subjektit politik PDK Agim Aliu. Sipas parashtruesit të ankesës kryeministri ka premtuar se çdo premtim i kandidatit në fjalë dot implementohet sepse do të ketë përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe sipas ti vetëm ky kandidatë do ta ketë përkrahjen ndërsa kandidatët tjera nuk do të kenë përkrahje.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi një CD ku është transmetuar emisioni.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, pretendimet ankimore dhe të gjitha provat e bashkangjitura ankesës dhe vlerësoi se pretendimet ankimore janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme përfshirë faktin se në asnjë provë nuk është vërtetuar se kandidati i PDK-së e ka përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, por ka theksuar se kandidati do ta ketë përkrahjen e PDK-së si subjekt politik kryetar i të cilës është Hashim Thaqi, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118

paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

PZAP nuk do t'i pranojë kërkasat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr.132/2012 më datën 03.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**

